

RRETH PROJEKTIT

“Mbështetja e zinxhirit të uleraue të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimit të eksportit”



I përkrahur nga donatori

“Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH”

mandatuar nga
Qeveria e
Republikës Federale
të Gjermanisë.



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Për informata:

IADK

Adresa :

Fshati : Sfaraçak i Ulët, nr.11,

42000 Vushtrri,

Kosovë

Tel : +383 (0) 44 777 036

+ 383 (0) 49 777 046


E-mail : info@iadc.org

Web faqe : www.iadc.org



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

“Mbështetja e zinxhirit të uleraue të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimit të eksportit”



Përkrahur nga:



giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Informata lidhje me projektin

Qëllimi i projektit është përmirësimi i qëndrueshmërisë së zinxhirit të ulerës dhe konsistencës së furnizimit për sektorin e BMA si dhe ngritja e kapaciteteve për pikat e grumbullimit të BMA dhe prodhuesëve primarë në konvertimin organik.

Projekti është dizajnuar për periudhën tre ujeçare Korrik 2018 – Dhjetor 2020, dhe do të zbatohet në të gjithë Kosovën.

Grupet e synuara të projektit:
Projekti ka tri grupe të synuara për përkrahje:

1. Prodhuesit primarë/mbledhësit e BMA nga zonat rurale në mbarë Kosovën që kanë tokë të kategorisë së lartë, janë të gatshëm të përmirësojnë cilësinë e produkteve të tyre dhe kanë përvujë në këtë sektor.

2. Pikat e grumbullimit të BMA që mbledhin një sërë produktesh nga prodhuesit primarë dhe kanë kushtet klimatike të favorshme, potencialin për rritjen e prodhimit, traditën në punë dhe kanë nevojë për përmirësimin e mëtejshëm të njohurive teknike në këtë sektor.

3. Kompania eksportuese Agroproduct SH.P.K që grumbullon produktet nga pikat e grumbullimit dhe eksporton ato, por është në nevojë të ketë një sistem të gjurmueshmërisë të secilit furnizues dhe prodhues primar në vend.

Në këtë fletëpalosje janë përshkruar disa nga aktivitetet kryesore të planifikuara të projektit, ku për gjatë 3 viteve do të përkrahen 50 fermerë (janë aprovuar) ndërsa ky numër mund të rritet deri në 200 fermerë.

Kush do të jenë përfituesit e projektit?

Përfitues të këtyre granteve do të jenë fillimisht 50 por që mund të rritet deri 200 fermerë që jetojnë në vise rurale me nivel të ulët të ardhurave dhe gjendje jo të mirë ekonomike, të cilët kanë kushte mesatare të punës në bujqësi, tokë, ujë dhe fuqi punëtore.

Cilat kultura të BMA do të përkrahë projekti?

Ky projekt ka për fokus të veçantë kultivimin e bimëve mjekësore aromatike fillimisht me: Rigon të Bardhë (*Origanum Heracleoticum*), Hithër (*Urtica Dioica*), Mentë (*Mentha Piperita*), por sipas kërkesës së fermerit, në vitet në vijim edhe BMA të tjera.

Projekti do t'i përkrahë fermerët në bazë të aktiviteteve të tyre dhe kulturat që janë të interesuar. Paketa do të varet në aktivitetet që aplikuesit janë të angazhuar. Grantet e projekti do të ofrojë: fidanë të BMA, sistemin e ujitjes, serrë tharëse, mekanizëm bujqësor për lehtësim të punës gjatë kultivimit të BMA.

Sa është shuma e granteve për përfitues?

Vlera mesatare e grantit (në të mira) për një përfitues do të jetë 2,500€, përfituesi do të bashkëfinancojë projektin me (400€). Ndërsa idetë për investime/grante do të përcaktohen nga aplikuesit në formularin për aplikim. Fokusi do të jetë shtimi i sipërfaqeve me BMA si dhe krijimi i qëndrueshmërisë dhe vazhdimsisë së këtij sektori.

Pas pranimit të aplikacioneve ekspertët e IADK-së do ta shqyrtojnë atë ide dhe potencialin e saj për të kryer furnizimet përfituesit e granteve.

IADK do të angazhojë ekspertët e saj për të trajnuar përfituesit se si të përdorin makineritë, të mbjellin fidanët, metodat e kultivimit të fidanëve dhe të kultivimit të kulturave të ndryshme të BMA.

Cilat janë përfitimet nga shërbimet profesionale të IADK-së?

Të gjithë përfituesit që do të përkrahen nga projekti do të monitorohen nga ekspertët e IADK-së në fermat e tyre dhe do t'u jepet të paktën 5 këshilla direkte. Këshillat direkte do të jenë në vazhdimësi gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit, sidomos pasi përfituesit kanë marrë grante pasi kanë nevojën për këshilla profesionale në sektorin e BMA.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet gjurmueshmërisë, prodhimitarisë organike sipas standardeve të BE-së për eksport dhe mbajtjes së dhënave për t'u certifikuar në bujqësi organike.

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit, përfituesit do të këshillohen për së afërmi nga ekspertët e IADK-së dhe do të u japin orientimin e duhur për të rritur fermën e tyre dhe për të qenë një aplikant potencial për MBPZHR-në për grante dhe pagesa direkte si dhe për tu mbështetur nga komuna në të ardhmen.

Ku duhet të aplikohet për grante?

Fermerët e interesuar për aplikim do të mund t'i marrin aplikacionet në sesione informuese që do të mbahen në komunat përkatëse apo në uebfaqen e IADK-së (www.iadk.org), dhe pas plotësimit, dokumentacionet e kërkuara me aplikacion të dorëzohen në zyrat e IADK-së.

Si bëhet përzgjedhja e përfituesve?

Pas pranimit të aplikacioneve një komision i përbashkët i ekspertëve të IADK-së, GIZ-it dhe kompanisë AgroProdukt SH.P.K, do të del në teren për të bërë përzgjedhjen e përfituesve në bazë të kritereve të poentimit.

Kur do të bëhen furnizimet?

IADK do të bëjë furnizimet gjatë sezonës ujeshhtë - pranverë, gjatë progresit të përfituesit me qëllim që të shfrytëzohen sa më mirë grantet.